



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura V  
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit  
S-037  
Prishtinë, më 23 korrik 2015

**P R O C E S V E R B A L**

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 23 KORRIK 2015**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi: Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të caktuar nga Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, si në vijim:

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Xhevahire Izmaqi, Shpejtim Bulliqi, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami, Ganimete Musliu, Armend Zemaj, Glauk Konjufca, Teuta Haxhiu, Nuredin Ibishi, Shqipe Pantina, Nait Hasani, Bekim Haxhiu, Selville Halimi dhe ministri Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me mosfunktionalizimin e Bordit të AKP-së i cili nuk është funksional nga data 1 shtator 2014 dhe se me vendit të kujt është duke i shfrytëzuar ndërmarrja “Trepça” këta 3 muajt e fundit fondet e AKP-së nga xhirollogaria e veçantë.

Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me mbrojtjen e ligjshmërisë sipas nenit 94 paragrafi 1 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së

Kosovës lidhur me përgjegjësinë për zbatimin e ligjit në lidhje me konfliktin e interesit në rastin e z. Besnik Berisha, këshilltar i Kryeministrit për çështjet të drejtësisë.  
Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetes Albulena Haxhiu.

Deputeti Rexhep Selimi parashtoi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me mospërgjegjëjen në pyetjet e parashtruara parlamentare nga ana e deputetëve.  
Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit Rexhep Selimi.

Deputetja Time Kadrijaj parashtoi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me projektin për ndërtimin e Shkollës Filllore “Edmond Hoxha” në Junik.  
Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Time Kadrijaj parashtoi pyetje për ministrin Lutfi Zharku në lidhje me vazhdimin për realizimin e projektit të rrugës Junik-Gjeravicë.  
Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Salihe Mustafa parashtoi pyetje për ministrin Valon Murati në lidhje me procesin për regjistrimin e Diasporës dhe rrjedhën e tij.  
Ministri Valon Murati iu përgjigj pyetjes së deputetes Salihe Mustafa.

Deputeti Daut Haradinaj parashtoi pyetje për ministrin Skender Hysni në lidhje me hartimin e Projektligjit për Pensionimin e parakohshëm të Policisë së Kosovës.  
Ministri Skender Hysni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi parashtoi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me pjesëmarrjen, siç tha ai të kryetarit të komunës së Mitrovicës së Veriut Goran Rakić si pjesë e delegacionit të Serbisë në bisedimet ndërshtetërore Kosovë-Serbi të mbajtura në Bruksel.  
Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputeti Ismajl Kurteshi parashtoi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me licencimin dhe kontrollin e çerdheve private në Republikën e Kosovës.  
Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputeti Bali Muharremaj parashtoi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me faktin se në ligjin e miratuar për rishikimin e buxhetit për vitin 2015 në arkën e shtetit janë 52 milion euro më pak. Ndërsa nga ana tjetër gjatë fushatës zgjedhore është premtuar rritje e buxhetit deri në 500 milion euro për çdo vit.  
Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit Bali Muharremaj.

Deputeti Mytaher Haskuka parashtoi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me atë se për çfarë arsye asnjë nga dëshmorët e kombit të rënë para vitit 1998 nuk është në listën e dëshmorëve dhe familjet e tyre nuk gëzojnë të drejtat e tyre që iu garantohen me ligj.  
Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit Mytaher Haskuka.

\* \* \*

Për plotësimin e rendit të ditës, deputeti Nait Hasani, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport propozoi që në seancën e sotme të procedohet edhe emërimi i anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Nait Hasani.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- shumica,  
Kundër -----0,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Nait Hasani që emërimi i anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore të radhitet si pika e katërt e rendit të ditës së kësaj seance.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

### **Rend dite**

- 3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,*
- 4. Emërimi i anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.*
- 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armë,*
- 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri dhe*
- 7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014.*

\* \* \*

### **3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Ministri Kujtim Shala, tha se ky projektligj ndryshon dhe plotëson ligjin aktual në fuqi, me qëllim të harmonizimit me direktivat të BE-së në fushën e së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

Më pas ai përmendi një mori direktivash të BE-së të cilat rregullojnë këtë fushë dhe më të cilat është harmonizuar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Kujtim Shala është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport; Bekim Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Ismajl Kurteshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS; Shukrije

Bytyqi, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Agim Aliu, Glauk Konjufca, Blerta Deliu-Kodra dhe Fisnik Ismajli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e Autorit dhe të drejtat e përafërta.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 74,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të drejtat e Autorit dhe të drejtat e përafërta.

Kuvendi ngarkoi Komisionin funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Komisionet e përhershme për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe Kuvendit ti paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

#### **4. Emërimi i anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore**

Kryetari tha se kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar në seancën plenare të mbajtur me 16 prill 2015, në të cilën ka pasur mungesë të kuorumit.

Ndërsa, në seancën e mbajtur 7 maj 2015 përsëri është procedura me këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo ka pasur mungesë të pjesëmarrjes së deputetëve në procedurën e votimit.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,  
Kundër ----- 3,  
Abstenime ----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

### **V E N D I M**

I. Emërohen anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në këtë përbërje:

1. Shafi Gashi,
2. Florim Isufi,
3. Arjete Miftari,
4. Doruntinë Matoshi,
5. Visar Haxhibeqiri,
6. Bego Kululleri,
7. Filjko Jovanoviq.

II. Mandati i të emëruarve nga pika I. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.

## **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armë**

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për armë.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së e paraqiti deputeti, Rexhep Selimi.

Deputeti Rexhep Selimi në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së dhe me pëlqimin e sponsorizuesit të Projektligjit, paraqiti para Kuvendit amendamentin e ri, nr. 65.

Fjala e deputetit Rexhep Selimi është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari, i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64 dhe 65.

Në fund, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 69,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin Nr. 05/L-022 për armë.

## **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri**

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së e paraqiti deputeti Anton Quni.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3 dhe 4.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 71,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligji Nr. 05/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri.

## **7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014**

Kryetari njoftoi deputetët se raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014, e ka shqyrtuar Komisioni Funksional Komisionit Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Deputetja Selvije Halimi, paraqiti dhe arsyetoi para kuvendit raportin me rekomandime në emër të Komisioni Funksional.

Fjala e deputetes Selvije Halimi është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Agim Ademaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Puhije Demaku, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Haxhi Shala, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, si dhe Albulena Haxhiu dhe Hajdar Beqa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- --49,  
Kundër ----- 18,  
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 13:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Kadri VESELI**

*Përgatiti:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*